

URDHËR
Nr. 1794, datë 26.9.2025

**PËR CAKTIMIN E DETYRAVE DHE DELEGIMIN E KOMPETENCAVE PËR
ZËVENDËSMINISTREN E MBROJTJES ZNJ. BLERINA ABRAZHDA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të nenit 22 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, ngarkohet të ndjekë, të monitorojë dhe të koordinojë me drejtoritë në përbërje të Ministrisë së Mbrojtjes, institucionet e varësisë, shoqëritë me aksionar shtetin që përfshihen në këtë fushë, ministritë e tjera dhe të përgjigjet para ministrit mbi proceset e lidhura me zhvillimin e industrisë ushtarake.
2. Ngarkohet zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, për zbatimin e këtij urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Pirro Vengu